VENDIM
Nr. 114, datë 7.10.2013

PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "SELCA ENERGJI" SHPK ME NR. 102, SERIA PV10P "PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE" NGA HEC "SELCË", TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 39, DATË 5.5.2010

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, pikat 2.3 dhe 2.4 të licencës "Për prodhimin e energjisë elektrike", si dhe neneve 13, 14 pika 2, 15 pikat 1, 2 /b, 3, 4 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.10.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë "Selca Energji" sh.p.k., për ndryshimin e licencës nr. 102, seria PV10P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 39, datë 5.5.2010 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Selca Energji" sh.p.k., plotëson kërkesat ligjore siç kërkohet nga rregullorja "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa "a": Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës.
- Neni 15, pika 4, germa "b": Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të modifikojë licencën me nr. 102, seria PV10P, për prodhimin e energjisë elektrike nga hec "Selcë" me fuqi 400 KW, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 39, datë 5.5.2010.
2. Fuqia e instaluar e hec "Selcë", nga 400 KW të bëhet 1600 KW.
3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI NË DETYRË
Shkëlqim Bozgo